

## PROJEKTET NDËRTIMORE DHE MJEDISI NË SHQIPËRI PËR PERIUdhËN 2016-17

ALEKO MIHO.<sup>1</sup>, ENTELA ÇOBANI.<sup>2</sup>,  
ROMINA KOTO.<sup>3</sup>, SEIT SHALLARI.<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë

<sup>2</sup>Universiteti Politeknik i Tiranës Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit,  
Departamenti Inxhinierisë së Mjedisit

<sup>3</sup>Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Departamenti i Agro-Mjedisit dhe Ekologjisë

e-mail: [aleko.miho@fshn.edu.al](mailto:aleko.miho@fshn.edu.al)

### Përmbledhje

Në këtë punim japim mendime mbi projektet ndërtimore, mbi VNM-të e tyre, të cilët janë shqyrtuar nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit (AKM) gjatë periudhës shkurt 2016 - maj 2017; kjo është bërë mbështetur në përvojën tonë për mbrojtjen e natyrës dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm pasurive të vendit. Këtu jepen këshillime për përmirësimin e cilësisë së ekspertizës mjedisore dhe të lejes mjedisore përkatëse, të përdorimit me kriter të tokës, për kontrollin e ujërave dhe të gërryerjes në veprimtaritë ndërtimore, minerare dhe gurore, për parandalimin e ndërtimeve në zonat e mbrojtura (HEC-e, resorte etj.), mbrojtjen e brezit ranor bregdetar etj. Në fund diskutohet për barrën që mbajnë sot burimet natyrore në vend (miniera, gurore, ujëra etj.) në lidhje me sektorët e tjerë të zhvillimit të vendit. Të gjitha këto ishin pjesë edhe e Raportit që i kemi dërguar Projektit IBECA si mbështetës i kësaj nisme, si dhe Drejtorisë së shqyrtimit të VNM-ve në AKM. Ne gjithmonë kemi bindjen se këto mund të jenë të vlefshme edhe për të ardhmen, për gjithë ekspertizën mjedisore, për AKM-në dhe Ministrinë e Mjedisit, si dhe për vetë Qeverinë shqiptare.

**Fjalëkyçe:** AKM, VNM, pasuritë natyrore, shfrytëzimi i qëndrueshëm.

### Abstract

In this paper we give opinions on construction projects, their EIAs, which have been reviewed by the National Environment Agency (NEA) during February 2016 - May 2017; this is done based on our experience in nature conservation and sustainable use of natural resources. Advises are given how to improve the quality of environmental expertise and related environmental permit, land use criteria, water and erosion control in construction, mining and quarrying activities, prevention of the construction activities (HPPs, resorts etc.) in protected areas, protection of the coastal sand belt, etc. We will discuss also the burden of today's natural resources (mines, quarries, waters, etc.) in Albania, compared with other sectors. All was also part of the Report we sent to the IBECA Project as a supporter of this initiative and the EIA Review Directorate at the NEA. We are conscious that these can be useful to improve further the environmental expertise and related permit, for NEA and MoE, as well as for the other responsible agencies of Albanian Government.

**Keywords:** NEA, EIA, natural resources, Sustainable use.

## **Hyrje**

Gjatë periudhës shkurt 2016 - maj 2017 u caktuan nga institucionet tona përkatëse si ekspertë këshillues në Komisionin e shqyrtimit të VNM-ve, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), Tiranë. Qysh në fillim vlen të përgëzojmë Ministrinë e Mjedisit, dhe në veçanti AKM për frymën për të pranuar ekspertë universitarë si të jashtëm në Komisionin e tyre në atë periudhë! Kjo ishte përvojë shumë e mirë edhe për ne për t'u njohur me: larminë e projekteve ndërtimore, cilësinë e ekspertizës mjedisore në vend, dhe zhvillimin e vendit në raport edhe me qëndrimin ndaj mjedisit.

Bëhet fjalë mbi 440 VNM projektesh ndërtimore të përhapura në gjithë vendin, ku rreth 45 ishin të thelluara (sipas Shtojcës I, Ligji 10440, dt. 7.7. 2011), të diskutuara në mbi 30 mbledhje. Prej tyre nga Sektori përkatës na janë dërguar për shqyrtim të veçantë paraprakisht rreth 290 raporte VNM-sh. Përbërja e gjithë VNM-ve të shqyrtuara të grupuara sipas tipeve kryesore jepen në pasqyrën 1.

Si pjesëmarrja në Komision, këshillimet e dhëna dhe përmbajtja e Raportit dhe e këtij punimi mbështeten në përvojën e gjithësecilit prej nesh dhe mësimet e nxjerra në fushat tona përkatëse: Biologji e Ruajtjes, Agromjedis, Inxhinieri mjedisi etj. Vlen të thuhet se e gjithë kjo është urë lidhëse ku shkenca bashkohet me praktikën dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

## **Materiali dhe metoda**

Mendimet tona mbi projektet e shqyrtuara janë mbështetur në frymën e qëndrimit ndaj mjedisit dhe shfrytëzimit të pasurive të vendit (biodiversitet, zonat e mbrojtura, legjislacion mjedisi, shfrytëzimi i qëndrueshëm etj.). Për këtë, këtu diskutohet: përmirësimi i cilësisë së ekspertizës mjedisore; përmirësimi i cilësisë së lejes mjedisore përkatëse; përdorimi me kriteri i tokës; kontrolli i ujërave nga subjektet ndërtimore dhe më pas gjatë procesit të punës; kontrolli i gërryerjes/erozionit në veprimtaritë ndërtimore, minerare dhe gurore; ndërtimet në zonat e mbrojtura (HEC-e, resorte etj.); mbrojtja e brezit ranor bregdetar etj.

## **Rezultate dhe diskutime**

Shtysa për këtë publikim është zhvillimi i qëndrueshëm dhe theksimi për të mbajtur parasysh rast pas rasti këtë parim gjatë zhvillimit të vendit. Qëndrueshmëri do të thotë të vendosësh në barazpeshë zhvillimin shoqëror me atë ekonomik, bashkë dhe me shfrytëzimin me kujdes të pasurive natyrore në vend. Kjo nënkupton përdorimin e pasurive biologjike dhe natyrore, si në përputhje dhe me mbrojtjen e mjedisit, në mënyrë që këto pasuri të ruhen dhe të ripërtërihen, që nevojat të plotësohen jo vetëm për brezat sot, por edhe për brezat e ardhëm. Ne ua mësojmë këtë edhe studentëve tanë, ekspertëve të ardhshëm, madje edhe nxënësve të shkollës. Kjo ka lindur dhe është përpunuar në teori nga përvoja e vendeve më të zhvilluara (madje edhe nga pësimet e tyre nga zbatimi i praktikave të paqëndrueshme!). Kjo thuhet qartë në shumë publikime shkencore, si Kahle

& Gurel-Atay (2014), Finn (2009), Grober (2007), Blewitt (2015), etj., si dhe në shumë akte ligjore dhe nënligjore në vend, duke filluar që nga Neni 59 i Kushtetutës sonë.

**Tabela 1.** Përmbledhja e grup-VNM-ve të shqyrtuara në Komisionin e AKM-së, gjatë periudhës shkurt 2016 - maj 2017 (ky grupim është arbitrar, i bërë prej nesh për arsye diskutimi në këtë publikim).

Veprimtaria / Gjithsej	444	Veprimtaria / Gjithsej vazhdim	
Ndërtim banesash, shërbime & resorte	69	Komplekse gazi, naftë, shërbime	14
Gurore, miniera, inerte etj.	65	Qenda shëndetësore, shkolla	11
HEC-e	56	Rehabilitime lumore dhe bregdetare	9
Rindërtim rruge, banesash, sheshe	52	Ujë mineral & pijshëm	8
Kapanone industriale etj.	35	Akuakulturë, përpunim peshku	7
Komplekse blegtorale, bujqësore etj.	29	Kanalizim & trajtim ujërash	6
Magazinë bujqësore & ushqimore	17	Komplekse sportive	6
Antena	16	Pije alkoolike, birrë	6
Nënstacione, parqe & rrjet elektrik	16	TAP	4
Depozitim & trajtim mbetjesh	15	Përpunime tekstile, fasoneri	3

**Veprimtaritë ndërtimore urbane brenda qyteteve dhe në periferinë e tyre:** ishin absolutisht sundues në numër gjatë kësaj periudhe (96 projekte; Tab. 1). Vëmendja në këto projekte ndërtimore shkon tek: **pushtimi pa kriter me ndërtime, dhe përdorim i keq i tokës.** Kush është pronar i një copë trualli brenda ose në periferi të zonave urbane është munduar ta verë në përdorim të ndërtimit të diçkaje për qëllime fitimi; po kjo po ndodh edhe për zona të tjera të lira pa pronar. Kjo dukuri ka rënduar shumë jo vetëm zonën Tiranë-Durrës, por edhe gjithë zonën tjetër bregdetare: Velipojë, Shëngjin, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Kasmil. Për këtë mjafton të vihen re pamjet satelitore, si ajo në figurën 1. Ne mendojmë se Qeveritë vendore duhet të **rishohin planet rregulluese, duke menduar për më shumë zona të lira pa ndërtime, hapësira të blerta, mes zonave urbane,** si kërkesë jetike për të zbuatur ndikimin urban, për mbrojtjen e shëndetit të vetë banorëve në këto zona, por edhe për mbrojtjen e natyrës.

Për më tepër, shumë nga këto **ndërtime janë në tokën bujqësore.** Vështirë të gjesh të dhëna të sakta për këtë, por ka konstatime nga ekspertë të fushës se hapësira e tokës bujqësore mund të jetë zvogëluar deri në 10% në këto vite tranzicioni, që për Shqipërinë është shumë. Këtu duhet patur parasysh se **Shqipëria renditet ndër vendet me shumë pak tokë buke.** Toka bujqësore zë 24.2% të sipërfaqes totale (pra rreth 695,520 ha) (ODA, 2012). Pra, sasia e tokës së bukës për banorë është vetëm 0.24 ha/banorë, e barabartë me më pak se 50 m x 50 m. Kjo është shumë e ulët, po qe se mbahet parasysh se për

të siguruar mbijetesën normale për një person nevojitet të paktën 0.5 ha tokë bujqësore (WWM, 2008). Për këtë, **kujdesi për tokën bujqësore duhet të jetë sfidë e vazhdueshme për Shqipërinë**, veçanërisht për vendimmarrjen!

**Veprimtaritë e guroreve dhe minierave** ishin, gjithashtu, në krye për nga numri (65 projekte; Tab. 1), por dhe nga rëndësia mjedisore. Këtu shqetësimet në vemendje janë: erozioni ose gërryerja e tokës, ndotja e ujërave me sedimente, me metale të rëndë, me baktere (koliforme, streptokoke), me ushqyes (N & P), me pesticide, herbicide etj.

Këtu duhet patur parasysh se **Shqipëria klasifikohet sot si vend me erozion të lartë dhe humbje të tokës**, dallohet për **ashpërsim të klimës dhe përmbytje**; kjo ndodh për shkak të tabanit gjeologjik, klimës dhe relievit të thyer kodrinor-malor; por këto nxiten shumë nga dëmtimi i mbulesës bimore, shpyllëzime pa kriter, urbanizim pa kriter (Fig. 1), përfshirë këtu dhe veprimtaritë minerare dhe guroret, djegie dhe kullotje e tepruar etj. Erozioni i tokës luhetet nga 20 deri 40 t/ha/vit, dhe në raste të skajshme deri në 100 t/ha/vit (Lako, 2012; Shuka *et al.*, 2008; Shuka *et al.*, 2011a; Shuka & Malo, 2010; Marko *et al.*, 2011). Nga të dhënat e Raportit për Mjedisin të AKM (2014), përmbajtja e grimcave TSS (*Total Suspended Solids*) në ujëra shkon deri në 226.3 mg/l në Ishëm, luhetet 79.6 – 112 mg/l në Erzen, deri në 74.4 mg/l në Shkumbin, deri në 222.2 mg/l në Seman, deri në 117 mg/l në Vjosë. Nga studimet e disa viteve më parë të Miho *et al.* (2005; 2009), TSS në lumenjtë shqiptarë është parë të shkojë 3-9 herë më shumë se vlera kufi 25 mg/l e standardit të BE-së (*Fish Directive 2006/44*) për mbijetesën e peshqve në ujërat sipërfaqësore. *Shih* dhe diskutimet përaktëse nga Shuka *et al.* (2011b), Miho *et al.* (2013) dhe Mullaj *et al.* (2017).

Nga veprimtaritë minerare në vendin tonë kanë dalë shumë sterile që mbeten rrugëve rreth minierës, të zbuluara, të shëmtuara. Për këtë minierat jo vetëm shtojnë erozionin, por dhe ndotin ujërat me metale të rëndë, krom, bakër, hekur, nikel etj. Gjurmët e kromit dhe bakrit nga minierat e Pukës dhe Mirditës, kanë shkuar nëpërmjet ujërave të Matit deri në deltën e Matit në Patok, për të cilat ka konstatime nga Çullaj *et al.* (2000), Gjoka *et al.* (2010), Abazi *et al.* (2013), dhe Koto *et al.* (2014), ose në trupin e bimëve (Shallari *et al.*, 1998; Demiraj *et al.*, 2017).

Nuro & Marku (2011) japin në mënyrë të përmbledhur, të dhëna mbi mbetjet e pesticideve për disa ekosisteme ujore shqiptare për periudhën 2005-2010, konkretisht në Detin Adriatik (Gjiri i Vlorës, Porto Romano dhe Velipojë), në lumin Buna, liqenet e Shkodrës, Butrintit dhe Ohrit, të matura këto në midhje dhe peshk. Këto të dhëna kapërcejnë kufirin e përgjithshëm të BE-së prej 0.01 mg/kg për mbetjet e pesticideve ([Http://miepo.md/](http://miepo.md/)). Miho *et al.* (2014) japin të dhëna mbi lulëzimin e cianobaktereve në liqenin e Fierzës, Kukës, në Korrik 2014, dukuri e përsëritur edhe sivjet në nëntor 2017 (*të dhëna të papublikuara*). Kjo dukuri e sjellë për herë të parë për ujërat e ëmbla shqiptare është shenjë e eutrofikimit kulturor që vjen nga shtimi i fosforit dhe azotit në ujëra, prej ujërave të papërpunuara, si ato urbane dhe

nga veprimtari të tjera. Po në këtë mënyrë, Miho *et al.* (2009) japin të dhëna për shtimin e bakteve koliformë në ujërat e ujëmbledhësit të Bovillës menjëherë pas rreshjeve të dendura (Hoxha & Emiri, *në këtë botim*).

Vlen të përmendim se shumë nga metalet e rëndë, pesticidet, lulëzimet e cianobaktareve etj. janë shumë helmuese, dhe shkaktojnë 'vdekje të heshtur' për njeriun dhe botën e gjallë për rreth, term i përdorur sot rëndom për këtë dukuri. Për më shumë mbi shkallën e rrezikut këshillojmë lexuesin të informohet duke lexuar publikimet përkatëse të toksikologjisë dhe sigurisë shëndetësore. Për më tepër aktiviteti minerar dhe guoret shpesh shëmtojnë rëndë peisazhin duke ulur vlerat turistike. Për këtë këshillohet vëmendja te **displinimi i ujërave të punës, të shiut**, përpunimi i tyre menjëherë në vend (p.sh. me dekantim), ripërtëritje e bimësisë përreth, pyllëzim i vazhdueshëm, përgjithësisht me bimësi vendase (Mullaj *et al.*, 2017). Këtu duhet theksuar se **mbulesa bimore** ka shumë rëndësi për mbrojtjen e tokës nga erozioni, nga lëndët ndotëse që ajo përmban, si dhe është rezerva kryesore ujore e saj.

Grupi i tretë i veprimtarive ishte **ndërtimi i HEC-eve në lumenj** (56 projekte; Tab. 1). Nuk jemi kundër ndërtimit të HEC-eve në mënyrë të prerë! Por gjatë periudhës 2005-2017 janë dhënë leje për të ndërtuar më shumë se 500 HEC-e, të vegjël dhe të mëdhenj të përhapur kudo në Shqipëri. Pra janë rreth 18 HPP/1000 km<sup>2</sup>, që është një barrë tepër e rëndë mjedisore, po qe se kemi parasysh **ndikimin sinergjik** ose **kumulues** të tyre, që e bën dhe më shqetësues këtë veprimtari. Pse kjo është një barrë e rëndë mjedisore? Sepse ekosistemet lumorë shqetësohen gjatë ndërtimit, por dhe gjatë punës në vite, nga rrugët e reja, digat, tunelet, kanalet, lëndët plasëse, linjat e transmetimit etj. Disa nga pasojat janë: gërryerje e shpatit (shpatet bregore, shpatet e brishta më sipër etj.), deri dhe në gërryerje të bregdetit pranë deltave lumore; ndotje e ujërave si diskutuam më sipër; varfërim biodiversiteti për llojet dhe habitatet e tyre (si ato ujore dhe ato tokësore pranë); ndryshime të biokorridorëve (për invertebrorët, peshqit dhe vertebrorët e tjerë ujqorë), deri dhe në ashpërsime mikroklimatike të ekosistemit lumor (në evapotranspirim-lagështi, në temperaturën e ajrit dhe të ujit etj.) (Mullaj *et al.*, 2017). Edhe përcaktimi i **prurjes ekologjike** në lumenjtë shqiptarë nuk duket se është shumë i qartë në aktet tona; ndoshta është përcaktuar jo në mënyrë shumë profesionale (Q350) për vendin tonë (REC, 2015), sa malor dhe aq mesdhetar. Kësaj i shtohet edhe mungesa e të dhënave, por dhe mungesa e e strukturave për të kontrolluar zbatimin e lejes së përdorimit të ujit dhe prurjen ekologjike në veçanti.

Një pjesë e HEC-eve, por edhe ndërtime të tjera (si komplekse të mëdha turistike) vazhdojnë ende të jepen brenda të **zonave të mbrojtura**, ose në bashkëveprim ekologjik me to. Kjo nuk mund të konsiderohet miqësore me natyrën, dhe nuk mund të jetë e qëndrueshme në parim, po qe se mbajmë parasysh pasojat që përmendura më sipër. Pse i mbrojmë ZM-të atëherë? Nga cilat veprimtari të dëmshme, nëse jo nga veprimtaritë ndërtimore të njeriut? Projektet ndërtimore të tilla janë në kundërshtim me ruajtjen e

integritetit të ZM-ve. Integriteti biologjik lidhet me gjendjen e përgjithshme të virgjër, të paprekur, të pacopëtuar të një ekosistemi. Zonat e mbrojtura dallohen për habitate natyrore me vlera të larta integriteti, që nënkupton larmi biologjike të lartë (bimore dhe shtazore, ujore dhe të steresë), aftësi strehimi dhe bashkëjetese të barabartë, të pashqetësuar dhe të përshtatur (përkufizim i përshtatur nga Frey, 1977).


Për këtë, zonat e mbrojtura mbahen larg shfrytëzimit nga njeriu për qëllime përfitimi të çastit, qoftë për përdorimin e drurit, të bimëve aromatiko-mjekësore, të kullotjes, dhe për më tepër edhe nga ndërtimet apo turizmi masiv; ato mbrohen rreptë nga zjarret, dhe nga shumë ndërhyrje që bien ndesh me integritetin e tyre. Parqet Kombëtare nuk janë në të vërtetë 'Parqe Turistike'! Është e vërtetë se aty ku natyra është e mbrojtur, e paprekur dhe me intergitet të lartë, ajo bëhet më tërheqëse për njeriun. Sa më e virgjër të jetë një zonë aq më shumë ofron ajo interes për një natyralist, për një dashamirës të natyrës, aq më e madhe është fuqia çlodhëse e saj. Por përfitimet nga një zonë e mbrojtur nuk duhen parë këtu, por tek detyrimi që ne kemi sot për të zhvilluar veten tonë bashkë me natyrën, për të bashkëjetuar me botën e gjallë, me florën, me faunën, për të sotmen dhe për të ardhmen.

Gjithashtu, ndërtimi brenda zonave pak të njohura, **potencialisht me vlera natyrore**, të cilat mund të mbrohen në të ardhmen, konsiderohet prej nesh jo miqësor me natyrën! Konkretisht, edhe pse jo me status mbrojtje, **lumi i Vjosës** është ekosistem potencialisht me vlera natyrore, si lumi i fundit në Europë, vërtet **lumë me rrjedhje të lirë** (*shih* <http://www.balkanrivers.net/>). Kjo është arsyeja pse mendimi profesional në vend dhe në mbarë botën kundërshton gjithmonë vendimmarrje të tilla, duke i quajtur tepër të nxituara, në kundërshtim me parimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Kjo përforcohet edhe nga përvoja të gabuara në vendet e zhvilluara; për shkak të vlerësimeve mjedisore të nxituara në të kaluarën, inxhinieria e lumenjve në vendet e industrializuara ka rezultuar me pasoja mjedisore negative, me prirje afatgjata, që kërkojnë masa të shtrenjta restaurimi, gjë që parashikohet edhe për digat në lumin e Vjosës. Këto ndërtime bien ndesh me zbatimin e standardeve të BE-së, Direktivën e Shpendëve dhe Habitaveve, Direktivën Kuadër të Ujit (WFD, 2000), apo me strategjinë e BE-së për të ndaluar humbjen e biodiversitetit deri në 2020.

**Projektet ndërtimore në zonën bregdetare** (urbanizim, infrastrukturë turistike etj.), sidomos atë adriatike (Velipojë, Kune-Vain, Patok, Golem, Shën Pjetër, Divjakë, Nartë etj.) nuk është mënyrë e mënçur shfrytëzimi. Dunat bregdetare, sëbashku me bimësinë dhe në veçanti me brezin pyjor halor janë habitate të ndjeshme, të brishta, por dhe mjaft jetike të vijës bregdetare. Dunat janë një brez ndërmjetës midis ujit dhe tokës që ndihmojnë në qëndrueshmërinë e bregdetit, duke zbutur ndikimin e detit në vijën bregdetare dhe anasjelltas, duke ruajtur cilësinë e ujit dhe të rërës etj. Shpesh habitate të tilla mbrohen në mënyrë të veçantë, si është edhe rasti në

bregdetin tonë, Karavasta-Divjakë, Velipojë, Nartë, Kune-Vain, Patok, Gjiri i Lalzit etj. Për më tepër, ato si të tilla e bëjnë peisazhin edhe shumë më tërheqës, duke mbajtur lart vlerat turistike dhe çlodhëse. Më shumë për këto vlera lexuesi i interesuar mund t'i gjejë në disa publikime, si Miho *et al.*, 2013, Koto *et al.* (2015), Koto & Bani (2014) etj.

Këshillimi ynë është **të rishihen planet rregulluese të hapësirës bregdetare** për të shpëtuar nga urbanizimi atë pjesë të brezit të dunave që ka mundur të shpëtojë deri tani nga pushtimi, sidomos atë pjesë që ndodhet brenda zonave të mbrojtura, si në PK të Divjakë-Karavastësë, peisazhet e Mbrojtur Vjosë – Nartë dhe Lumi Buna-Velipojë, por edhe gjithë pjesën tjetër të bregdetit Adriatik. Për këtë qëndrim ndryshe në bregdetin shqiptar këshillojmë të merret shembull nga fqinjët tanë. Përvoja malazeze flet ndryshe, duke i ndalur ndërtimet mbi 1 km larg nga bregu i detit dhe duke e lënë të paprekur gjithë brezin e dunave ranore (Fig. 1). Kjo padyshim ka arsyt e veta, qoftë në mbrojtjen e vlerave natyrore dhe biologjike të zonës, por edhe në qëndrueshmërinë e investimeve ndërtimore!



**Figura 1:** Pamje e zonës ndërkufitare të deltës së Bunës, ku duken qartë dy pamje zhvillimore të kundërta në të dy anët e kufirit Shqiptaro-Malazez!

Ne duam të ndajmë shqetësimin se **shqyrtimi i VNM-ve për Drejtorinë përkatëse në AKM është barrë e madhe**. Drejtoria e Vlerësimit Mjedisor ka në organikën e vet gjithsej 11 persona të ndarë në tre sektorë: Sektori i VNM-ve (3&1 persona), Sektori Lejeve Mjedisore (3&1) dhe Sektori i Përgjegjësi Mjedisore (2&1) (përditësuar nga:

<http://www.akm.gov.al/assets/rregullore-e-funksionimit-te-akm-se-dhe-drm-ve.pdf>).

Komisioni shqyrton nga 10 deri në 20 dosje në javë, mesatarisht rreth 15 dosje për mbledhje, të cilat dhe mund të shtohen në të ardhmen. Dosja e një aplikimi është e përbërë nga disa dokumenta, ku vetëm Raporti i VNM-së shkon në disa dhjetra faqe (mesatarisht 60-70 faqe). Do të këshillojmë AKM-në të kërkojë **shtim të personelit dhe më shumë specializim të brendshëm** për shqyrtimin e këtyre praktikave për lëshimin e lejes mjedisore. Por po kaq e rëndësishme është që AKM të nxitë dhe mbështesë njëkohësisht **kualifikimin në vazhdim të ekspertëve** të saj, kjo jo vetëm në Drejtorinë e VNM-ve, por edhe në drejtoritë e tjera.

Nga sa ne kemi vënë re duket se mjedisi në Shqipëri vazhdon të mbetet 'jetim'! Përpilimi i Raporteve të VNM-ve nuk duket shumë i drejtë: Vështirë se një studio apo ekspert i kontraktuar nga një subjekt ndërtimor të anullopë një projekt kur ai bie ndesh me vlerat e natyrës! Fakt është që sa herë që jepet leja koncesionare nga Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Energjetikës, për ndërtim apo shfrytëzim të një zone, e gjithë ekspertiza përpiket të shpjegojë se si ndërtimi apo shfrytëzimi të jetë sa më miqësor me natyrën, duke bërë për këtë avokatinë e subjektit ndërtimor, por kurrë oponencën apo kthimin mbrapsht si ndërtim të pamundshëm. Këtë kontradiktë duhet ta ketë mirë parasysh AKM, Ministria e Mjedisit dhe Qeveria Shqiptare në të ardhmen, duke krijuar **pavarësi të plotë të ekspertizës mjedisore** nga subjekti ndërtimor, e cila kërkon me siguri edhe një rregullim ligjor.

Nga cilësia e raporteve të VNM-ve mund të pohojmë se **kanë shpesh mangësi në formë dhe përmbajtjen e tyre**. Konkretisht, përshkrimi i zonës ku kërkohet të ndërtohet apo shfrytëzohet është shpesh i përciptë dhe jo profesional, tepër i përgjithshëm, me të dhëna jo shumë bindëse, pa u ndalur konkretisht në përshkrimin e vetë zonës që parashikohet të preket, jo shpesh me të dhëna konkrete dhe të përditësuara, me mangësi në vetitë fiziko-gjeografike, ajrin, ujin, tokën, biodiversitetin etj. Thuajse të gjitha raportet e VNM-ve mjedisore shoqërohen me harta ose foto jo shumë cilësore, jo të qarta dhe të etiketuara mirë, ndonjëherë dhe me koordinata të pasakta.

Në raporte të tilla ka shumë rëndësi edhe shqyrtimi i veprimtarive të tjera të ngjashme në afërsi dhe ndikimi sinergjik apo kumulativ mes tyre. Kuptohet edhe shkrimi akademik dhe cilësitë drejtshkrimore kanë shumë rëndësi që Raporti të kuptohet si duhet nga gjithë vendimmarrësit dhe të interesuarit e tjerë të kësaj linje. Kujdes duhet patur për plagjaturën, por dhe autoplagjiaturën që vihet re rëndom! Për këtë, këshillojmë fort që AKM dhe Ministria e Mjedisit, të nxitë me këmbëngulje **kualifikimin në vazhdim dhe akreditimin real të studiove dhe ekspertëve** të licensuar mjedisorë.

Nga një vështrim i përgjithshëm i gjithë projekteve ndërtimore që janë shqyrtuar nga AKM për më shumë se një vit (Tab. 1) vihet re se Shqipëria vazhdon të mbështetet te sektori i ndërtimit dhe tek shfrytëzimi i burimeve natyrore në zhvillimin e saj. Konkretisht: guroret, minierat, inertet lumore etj. janë gjithsej 65 projekte, ose 15% e projekteve të shqyrtuara, kurse HEC-



et janë 56 projekte, ose (13%), pra gjithsej 28% nga gjithë projektet e shqyrtuara.

Duhet thënë se burimet natyrore nuk janë të pafundme, disa janë **ripërtëritëse** (pyje, bimë aromatiko mjekësore, peshq dhe molusqe etj.), edhe pse ripërtërihen me shumë vështirësi kur ato shfrytëzohen pa kriter, por të tjera **nuk janë ripërtëritëse** (minerale, gurë mermeri, naftë dhe gaz etj.). Për këtë ka shumë rëndësi që lejimi i shfrytëzimit të bëhet me përgjegjësi dhe profesionalizëm, nga Agjencitë dhe Drejtoritë përgjegjëse të MEI, MMJ etj., duke patur parasysh përdorimin me kriter të tyre.

Ecuria në gjithë spektrin e sektorëve të zhillimit ekonomik do të ishte më e qëndrueshme se mbështetja vetëm në sektorin e ndërtimit (ndërtim banesash, shërbime & resorte, gjithsej 69 projekte), si dhe në miniera, gurore dhe HEC-e (mbi 120 projekte gjithsej) (Tab.1); për këtë këshillohet që Qeveria dhe drejtoritë përkatëse **të nxitin investitorët edhe në sektorët prodhues, përpunues**, bujqësi moderne (përfshirë edhe kultivim bimësh industriale, pylltari, akuakulturë dhe ripeshkëzim ujëmbledhësish), industri e lehtë dhe përpunuese, infrastrukturë rrugore dhe turizën. Kjo sjell edhe më shumë punësim, por edhe më shumë të mira materiale me kosto më të lirë. Për më tepër, zhvillimi në sektorët prodhues do të shkarkojë edhe barrën e rëndë që mban sot mjedisi, pasuritë natyrore në ekonominë shqiptare.

### Falënderime

Falenderojmë Ministrinë e Mjedisit, dhe në veçanti AKM për frymën e hapur për të pranuar ekspertë universitarë si të jashtëm në Komisionin e tyre!

Projekti IBECA (projekt i Delegacionit të BE-së në Shqipëri; [www.ibeca.al/](http://www.ibeca.al/)) mbështeti qëndrimin tonë si ekspertë të jashtëm në AKM!

Falenderojmë institucionet tona përkatëse, Universitetin e Tiranës, Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin Politeknik të Tiranës që lejuan pjesëmarrjen tonë në këtë këshillim!

### Literatura

Abazi U., Shumeli A., Kopali A., Stasa J., Laska A., Laze P. (2013): Contents of heavy metals in surface water and sediments in Mati and Gjanica Rivers in Albania. Food, Agriculture and Environment (JFAE). ISSN: 1459-0263, Vol. 11, Issue 3&4: 2227-2231. Publisher: WFL

AKM (Ed.) (2014): Raporti për Gjëndjen e Mjedisit. Ministria e Mjedisit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Tiranë: 132

[http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Monitorim\\_Mjedisor/Raporti\\_gjendjes\\_mjedisit\\_20131.pdf](http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Monitorim_Mjedisor/Raporti_gjendjes_mjedisit_20131.pdf)

Blewitt J. (2015): Understanding Sustainable Development. Second edition. Published by Routledge, London. 394. ISBN 10: 041570782X ISBN 13: 9780415707824

Çullaj A., Celo V., Babi D. (2000): Analytical investigation of heavy metal content in sediments of Albanian coast. Journal of Environmental Protection and Ecology (JEPE), 1. Balkan Environmental Association (B.EN.A.) ed. Sofia, Bulgaria: 81-90

- Demiraj E., Malltezi J., Shallari S., Sulçe S. (2017): Heavy metals in water, sediments and macrophytes in the Shkodra Lake. 7th International Conference on Biological, Chemical & Environmental Sciences (BCES-2017), Budapest, Hungary
- Finn D. (2009): Our Uncertain Future: Can Good Planning Create Sustainable Communities? University of Illinois
- Fish Directive 2006/44/EC of the European Parliament and of the Council of 6 September 2006 on the quality of fresh waters needing protection or improvement in order to support fish life  
<http://eur-lex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/?uri=CELEX:32006L0044>
- Frey D. (1977): Biological integrity of water: an historical approach. Archived December 17, 2008, at the Wayback Machine. Pages 127-140 in Ballentine and Guarraia, op. cit  
[https://web.archive.org/web/20081217084900/http://www.epa.gov/bioindicators/pdf/frey\\_1977.pdf](https://web.archive.org/web/20081217084900/http://www.epa.gov/bioindicators/pdf/frey_1977.pdf)
- Gjoka F., Tabaku V., Salillari I., Henningsen P-F, Duering R-A. (2010): Heavy metals in sediments from the Fani and Mati rivers Albania. Carpathian journal of earth and environmental sciences 5(2): 153-160  
[https://www.researchgate.net/publication/289196456\\_Heavy\\_metals\\_in\\_sediments\\_from\\_the\\_Fani\\_and\\_Mati\\_rivers\\_Albania](https://www.researchgate.net/publication/289196456_Heavy_metals_in_sediments_from_the_Fani_and_Mati_rivers_Albania)
- Grober U. (2007): Deep roots - A conceptual history of "sustainable development" (Nachhaltigkeit), Wissenschaftszentrum Berlin für Sozialforschung  
[Http://miepo.md/public/files/cbi/eulegislation.food/2012\\_EU\\_legislation\\_Maximum\\_Residue\\_Levels\\_MRLs\\_of\\_pesticides\\_in\\_food.pdf](Http://miepo.md/public/files/cbi/eulegislation.food/2012_EU_legislation_Maximum_Residue_Levels_MRLs_of_pesticides_in_food.pdf)
- Kahle R.L., Gurel-Atay E. Eds. (2014): Communicating Sustainability for the Green Economy. New York: M.E. Sharpe. ISBN 978-0-7656-3680-5
- Koto R., Bani A., Bani E., Dautaj A. (2015): The economic values of ecosystem goods and services in Karavasta Lagoon. Albania. 18th International Symposium on Environmental Pollution and its impact on life in the Mediterranean region (Poster). Crete, Greece
- Koto R., Bani A. (2014): Assessment of goods and services assets in Karavasta lagoon. Green Energy and Environmental Science in Albania, Tirana, Conference proceedings
- Koto R., Bani A., Topi T., Topi M. (2014): Water quality and heavy metal content of Karavasta lagoon in Albania. Fresenius Environmental Bulletin, Vol. 23 (No12b): 3296-3002
- Lako A. (2012): Assessment of Soil Erosion Risk in Albania. Journal of Environmental Science and Engineering B1: 1175-1178. Formerly part of Journal of Environmental Science and Engineering, ISSN 1934-8932  
<http://www.davidpublishing.com/davidpublishing/Upfile/1/21/2013/2013012103145540.pdf>
- Marko O., Lako A. Çobani E. (2011): Evaluation of Soil Erosion in the Area of Kallmet: Lezha District. Geo-Frontiers Congress 2011. DOI10.1061/41165(397)151
- Miho A. (2014): Overview on Bioquality of Albanian surface waters based on microscopic algae. International Conference on Applied Biotechnology (ICAB-2014), organized and supported by FNS, UT, Tirana, 22 September 2014. Book of Proceedings: 11-16
- Miho A., Çullaj A., Bachofen R. (Eds.) (2009): Bovilla (Albania) – Limnological Study / Studim Limnologjik. Julvin 2, Tiranë: 350 faqe. ISBN 978-99956-14-29-4.  
<http://www.fshn.edu.al/home/publikime> shkencore

- Miho A., Cullaj A., Hasko A., Lazo P., Kupe L., Schanz F., Brandl H., Bachofen R., Baraj B. (2005): Gjendja mjedisore e disa lumenjve të Ultësirës Adriatike Shqiptare. / Environmental state of some rivers of Albanian Adriatic Lowland. University of Tirana, Faculty of Natural Sciences, (In Albanian with a summary in English): 267 faqe. ISBN 99943-681-9-2. <http://www.fshn.edu.al/home/publikimeshkencore>
- Miho A., Hallaçi B., Palushi A., Shahini R. (2014): Vrojtım fillestar i lulëzimit të cianobakterit *Aphanizomenon flos-aquae* në liqenin e Fierzës, Kukës. Buletini i Shkencave Natyrore (BSHN), Faculty of Natural Sciences, University of Tirana: Vol. 18: 38-48. <http://buletini.fshn.edu.al/>
- Miho A., Kashta L., Beqiraj S. (2013): Between the Land and the Sea - Ecoguide to discover the transitional waters of Albania. Julvin 2, Tirana. 1-462. ISBN 978-9928-137-27-2. <http://www.fshn.edu.al/home/publikime-shkencore>
- Mullaj A., Hoda P., Shuka L., Miho A., Bego F., Qirjo M. (2017): About green development in Albania. Albanian Journal of Agricultural Sciences (AJAS), Special edition, Agricultural University of Tirana, Albania: 31-50  
[https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/rssb/biotech\\_2](https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/rssb/biotech_2)
- Nuro A., Marku E. (2011): Organochlorine Pesticides Residues for some Aquatic Systems in Albania, Pesticides - Formulations, Effects, Fate, Prof. Margarita Stoytcheva (Ed.), ISBN: 978-953-307-532-7, InTech, Available from:  
<http://www.intechopen.com/books/pesticides-formulations-effects-fate/organochlorine-pesticides-residues-for-some-aquatic-systems-in-alb>
- ODA (2012): Struktura e tokës sipas Qarqeve në Shqipëri (2011). Ministria e Bujqësisë, Ushqimit, dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Open Data Albania. [http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/703/Struktura-e-tokessipas-Qarqeve-ne-Shqiperi-\(2011\)#sthash.Py6UhAPn.dpuf](http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/703/Struktura-e-tokessipas-Qarqeve-ne-Shqiperi-(2011)#sthash.Py6UhAPn.dpuf)
- REC (Ed.) (2015): Alternativa mjedisore e HEC-eve të vegjël. Studim alternativ për ndikimin social, ekonomik dhe mjedisor të HEC-eve të vegjël në rrjedhjet ujore në Shqipëri. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Tiranë: 1-58  
[http://documents.rec.org/publications/alternativa\\_mjedisore\\_e\\_heceve\\_te\\_vegjel.pdf](http://documents.rec.org/publications/alternativa_mjedisore_e_heceve_te_vegjel.pdf)
- Shallari S., Schwartz C., Hasko A., Morel J.L. (1998): Heavy metals in soils and plants of serpentine and industrial sites of Albania. Science Total Environ., 209: 133-142  
<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/9514035>
- Shuka L., Çullaj A., Shumka S., Miho A., Duka S., Bachofen R. (2011b): The spatial and temporal variability of limnological properties of Bovilla Reservoir (Tirana). Water Resource Management. 25: 3027–3039. © Springer. DOI 10.1007/s11269-011-9788-z. <http://link.springer.com/article/10.1007/s11269-011-9788-z#page-1>
- Shuka L., Malltezi J., Mersinllari M., Vardhami I. (2008): Dynamics of vegetation cover of Prespa Lakes and its watershed (Albanian side). Proceedings BALWOIS: 1-8:
- Shuka L., Malo S. (2010): The transboundary important plant areas as conservation units of European green belt (Eastern Albanian zone). Journal of Environmental Protection and Ecology..11, (3): 866–874
- Shuka L., Malo S., Vardhami I. (2011a): The impact of global warming in Southern Albanian grassland ecosystems. Proceedings of ICE, Tirana: 656-670
- WWM (Ed.) (2004): World Population, Agriculture, and Malnutrition. World Watch Magazine, September/October 2004, Volume 17, No. 5  
<http://www.worldwatch.org/node/554>